

**RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN**

“PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR LLOJIN E
DOKUMENTEVE, PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE TË
SHQYRTIMIT TË KËRKESËS, MËNYRËN E PAGESËS, NUMRIN E
NDËRTESAVE PËR ZYRAT VENDORE DHE PËR KUFIJTË
MAKSIMALË TË QIRASË PËR ZYRAT QENDRORE DHE VENDORE TË
PARTIVE POLITIKE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Projektvendimi ka si qëllim përcaktimin e rregullave për llojin e dokumenteve, procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe kufijtë maksimalë të qirasë lidhur me të drejtën e partive politike për t’u pajisur me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe vendore.

Përmes projektaktit të propozuar synohet të plotësohet kuadri ligjor lidhur me të drejtën e partive politike për t’u pajisur me ndërtesë, në zbatim të ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.

**II.VLERËSIMI I PROJEKT VENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.**

Ky projektvendim është bashkëpropozim i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ai nuk është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2023 për këto institucione dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME**

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike”

Në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, shteti lehtëson veprimtarinë e partive politike. Lehtësimi nga shteti i veprimtarisë së partive politike përfshin edhe të drejtën e partive parlamentare dhe partive politike, mesatarja e votave të së cilave në tri zgjedhjet e fundit parlamentare ka qenë mbi 1 për qind në shkallë vendi, për t’u pajisur me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore.

Pajisja me ndërtesë realizohet përmes lidhjes së një kontrate huapërdorje ndërmjet partisë politike përfituese dhe ministrit të Brendshëm, për pronat shtetërore, në administrim të pushtetit qendror, dhe kryetarit të bashkisë, për pronat që janë pronësi ose në përdorim të pushtetit vendor.

Kur nuk gjenden ndërtesa të lira, shteti merr përsipër pagesën e qirasë së selisë qendrore dhe të zyrave vendore të partisë politike. Ligji nr.8580/2000, i ndryshuar, ka autorizuar Këshillin e Ministrave që, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave, të përcaktojë rregulla më të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë.

Këto elemente synohet të përcaktohen nga projektakti i propozuar, i cili do të garantojë realizimin e procedurës së pagimit nga shteti të qirasë për selinë qendrore dhe zyrat vendore të partisë politike, që plotëson kushtet sipas ligjit, gjë e cila deri më tani ka hasur pengesë për shkak të mos parashikimit të dokumenteve të nevojshme për të paraqitur kërkesën, procedurës për shqyrtimin e saj, mënyrën e pagimit të qirasë dhe kufijtë maksimalë të saj.

Sa më sipër, projektakti i propozuar vlerësohet se sjell impakt pozitiv për partitë politike dhe garanton të drejtën e tyre për pajisje me ndërtesë për selinë qendrore dhe zyrat vendore, në përputhje me kërkesat e ligjit.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 22/1, pika 3, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike”

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS e BASHKIMIT EUROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me aktet e Bashkimit Evropian.

VI.PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim përmban 17 dispozita, përmbajtja e të cilave shpjegohet si vijon:

Në pikën 1 përcaktohet objekti i projektaktit në përputhje me autorizimin ligjor dhe çështjet që trajtohen në përmbajtje të projektvendimit.

Në pika 2 dhe 3 përcaktohet e drejta e partisë politike, që përmbush kushtet sipas ligjit nr.8580/2000, të ndryshuar, për të paraqitur kërkesë për pajisje me ndërtesë dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën.

Në pikën 4 përcaktohen veprimet që ndërmerr organi të cilit i është drejtuar kërkesa, pas verifikimit paraprak të saj.

Në pikat 5 dhe 6 përcaktohet bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme apo bashkisë, varësisht ku është drejtuar kërkesa, me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për evidentimin e ndërtesave të lira në administrim të pushtetit qendror, ose në pronësi apo përdorim të pushtetit vendor.

Në pikat 7 dhe 8 përcaktohet procedura e shqyrtimit të kërkesës dhe përgatitja e një relacioni shpjegues, për secilën parti politike, që ka paraqitur kërkesë, ku pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e kërkesës për pajisje me ndërtesë.

Në pikat 9 dhe 10 përcaktohet se kur kërkesa është pranuar dhe ka ndërtesa të lira, ministri i Brendshëm apo kryetari i bashkisë, sipas rastit, lidh kontratë huapërdorje me partinë politike që ka të drejtën për pajisjen me ndërtesë dhe ka detyrimin për të përcjellë një kopje të kësaj kontrate pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike”

Në pikën 11 përcaktohen dokumentet që duhet të paraqiten nga partia politike për të kërkuar pagesën e qirasë nga shteti, në rastin kur nuk gjenden ndërtesa të lira që mund t'i vihen në dispozicion.

Në pikat 12 dhe 13 përcaktohet mënyra e pagimit të qirasë së ndërtesave nga shteti. Kjo mënyrë është zgjedhur përmes ndihmës financiare vjetore të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me ligjin nr.8580/2000, të ndryshuar. KQZ, në përcaktimin e masës së ndihmës financiare vjetore për partitë politike, mban në konsideratë edhe masën për pagimin e qirasë për zyrën qendrore dhe zyrat vendore të partive politike, sipas kontratave të qirasë të përcjella nga partitë politike.

Në pikat 14 dhe 15 përcaktohen numri i zyrave vendore për të cilat shteti merr përsipër të paguajë kontratën e qirasë dhe kufijtë maksimalë të saj.

Në pikën 16 përcaktohet se efektet financiare për përballimin e shpenzimeve për pagesën e qirave të ndërtesave për selinë qendrore ose zyrat vendore të partive politike, përballohen nga buxheti i shtetit në formën e fondit që shërben si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike.

Në pikën 17 përcaktohet se organet që ngarkohen me zbatimin e aktit janë Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njësitë e qeverisjes vendore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit janë Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njësitë e qeverisjes vendore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe do përcillet për mendim pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike"

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim shoqërohet me efekte financiare, të cilat do të përlllogariten varësisht numrit të selive qendrore dhe vendore për të cilat do të mbulohet pagesa e qirasë nga shtetit. Ky është një detyrim që buron nga ligji nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe efektet financiare do të mbulohen nga buxheti i shtetit.

MINISTRI

Ulsi Manja

MINISTRI

Delina Ibrahimaj

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike”